



## VENDIMI I DYTË MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT

Data e miratimit: 7 mars 2017

Numri i lëndës: 2014-32

L.O.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 7 mars 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar  
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Noora Aarnio, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### I. VENDIMET E PANELIT TË DATËS 11 NËNTOR 2015 DHE 19 TETOR 2016

1. Me 11 nëntor 2015, Paneli ka nxjerrë vendimin në lidhje me ankesën e parashtruar nga L.O. kundër EULEX-it dhe ka bërë një sërë rekomandimesh për shefin e Misionit (ShM) në përputhje me Rregullën 34 të Rregullores së Punës. Në vendim thuhet si në vijim:

“Paneli, njëzëri

SHPALL ANKESAT LIDHUR ME NENET 2 DHE 3 (PJESET PROCEDURALE) DHE NENET 8 DHE 13 TE KONVENTES TE PRANUESHME,

GJEN NJE SHKELJE TE KETYRE TE DREJTAVE, dhe

DEKLARON se në bazë të gjetjeve të mësipërme të fakteve dhe ligjit, Paneli gjen të përshtatshme që të bëjë rekomandime për ShM-në, dhe

#### REKOMANDON VEPRIMET E MËPOSHTME KORRIGJUESE

- a. ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë ku pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankueses që i atribuohen veprimeve [dhe/ose mosveprimet] të EULEX-it në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv;
- b. ShM-ja duhet t'i udhëzoj të gjitha organet e Misionit, të cilët janë në kontakt me viktimat e supozuara të shkeljes së të drejtave (ose të afërmve të tyre) që të sigurojnë se në të gjitha komunikimet me ta të komunikohet me masën e nevojshme të shpejtësisë, zellit dhe kujdesit të domosdoshëm pér ta ditur vuajtjen emocionale të bashkëbiseduesit të tyre. Nëse është e nevojshme, ShM-ja duhet të konsideroj miratimin e udhëzimeve më hollësish duke përcaktuar se çfarë mund të nënkuptoj në rrethana konkrete ky udhëzim i përgjithshëm.
- c. ShM-ja duhet të siguroj që të gjitha organet hetuese në kuadër të Misionit (TFHS dhe prokurorët e EULEX-it) kanë në dispozicion burimet e nevojshme dhe mbështetje pér të përbushur misionin e tyre në mënyrë efektive dhe në përputhje me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut të të gjithë të përfshirëve aty. Pér këtë qëllim dhe nëse konsiderohet e nevojshme ShM-ja duhet të kërkoj burime shtesë pér këto organe në mënyrë që ata të mund të kryejnë funksionet e tyre shpejtë, me kujdes dhe në mënyrë efektive në të gjitha rastet.
- d. ShM-ja duhet të kërkoj që të qartësohet marrëdhënia midis Misionit dhe TFHS-së me qëllim që të sigurohet mbrojtja efektive e të drejtave dhe të garantohet se secili organ që është në krye të çështjes ofron informacionin e duhur dhe të mjaftueshëm pér ankuesit. Nëse është e nevojshme, duhet të kërkohet autorizimi nga BE-ja pér të bërë publike bazën ligjore që rregullon punën e TFHS-së. Kjo gjithashtu në masë të madhe do të kontribuoj në sjelljen e transparencës dhe llogaridhënieς më të madhe pér këtë mekanizëm.
- e. ShM-ja duhet t'iu bëjë të ditur TFHS-së dhe shteteve që mbështesin aktivitetet e tij rëndësinë që rastet e tillë duhet të hetohen në mënyrë të plotë dhe efektive dhe se kudo që të dyshuarit të identifikohen të sillen para drejtësisë menjëherë dhe në mënyrë të drejtë.
- f. ShM-ja duhet t'iu bëjë të ditur zyrtarëve kompetentë të TFHS-së rëndësinë dhe nevojën pér të informuar viktimat rreth aspektave të

përgjithshme të hetimit të tyre në mënyrë që t'i njoftojnë ata rreth përpjekjeve dhe angazhimit të tyre për të arritur drejtësinë për ta.

2. Përmes letrës së datës 29 prillit 2016, shefi i Misionit në largim, Gabriele Meucci i kishte adresuar rekomandimet e Panelit.
3. Në një vendim të datës 19 tetor 2016, Paneli ka konstatuar se nuk ishte i bindur që ShM-ja deri më tanë i kishte adresuar rekomandimet e Panelit në mënyrë të përshtatshme dhe efektive. Paneli ka ftuar ShM-në të rishqyrtojë qëndrimin e saj në lidhje me rekomandimet e Panelit.
4. Ky vendim përbën vazhdimësi të vendimit të Panelit të datës 11 nëntor 2015 dhe 19 tetor 2016 dhe të rekomandimeve të bëra në të.
5. Kompetencat dhe autoriteti i Panelit për të vazhduar me vendimet dhe rekomandimet e tij është paraparë në rregullën 45 e tutje të Rregullores së Punës së Panelit (për shembull shih vendimet në zbatimin e rekomandimeve *Desanka dhe Goran Stanisic kundër EULEX-it*, 2012-22, 29 shkurt 2016, § 3; *X dhe 115 ankues të tjerë kundër EULEX-it*, 2011-20, 11 nëntor 2015, § 3).

## **II. INFORMACIONI I MARRË NGA SHEFJA E MISIONIT TË EULEX-IT LIDHUR ME ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT**

6. Në bazë të vendimit të Panelit të datës 19 tetorit 2016, përmes një letre të datës 8 dhjetor 2016, ShM-ja ka ofruar informacion të mëtejshëm lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Panelit.

## **III. VLERËSIMI NGA PANELI**

7. Paneli vëren me kënaqësi se ShM-ja ka pranuar ftesën e Panelit për të rishqyrtuar pozicionin e marrë nga paraardhësi i saj në lidhje me këtë rast.
8. Sa i përket rekomandimit të Panelit se ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë ku pranon se rr Ethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankuesit që i ngarkohen veprimeve dhe/ose mosveprimeve të EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv (shih par. 1(a) më lartë), ShM-ja ka thënë si në vijim:

“Në lidhje me rekomandimin e parë të Panelit, me kujdes e kam konsideruar përbajtjen e vendimit të fundit të Panelit dhe arsyetimin e dhënë aty. Megjithatë, e përsëris politikën e Misionit që mos t’iu pranohet shprehimi i ankuesve se EULEX-i ka shkelur të drejtat e tij/saj të njeriut. Do të doja që të njoftoj Panelin se me kalimin e strukturave të Task Forcës Hetuese Speciale (“TFHS”) në Zyrën e Prokurorit Special (“ZPS”), hetimi i këtij rasti tanë bie nën ZPS, e cila është plotësisht e pavarur nga strukturat e EULEX-it, duke qenë se është themeluar përmes ligjit nr. 05/L-053, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës me datën 3 gusht 2015”.

9. Paneli vëren me keqardhje se kjo ka qenë praktikë e vazhdueshme e Misionit që të refuzojë apo që mos të pranoj zyrtarisht përgjegjësinë për shkeljen e të drejtave të njeriut të ankuesit, aty ku Paneli ka konstatuar se kjo kishte ndodhur. Një pranim i tillë do të ofronte një formë të drejtë të shpërblimit në një lëndë si kjo për të korrigjuar gabimin e bërë ndaj ankuesit nga ana e Misionit. Kjo formë e lehtësimit është edhe më e rëndësishme në kontekstin e tanishëm pasi që Paneli nuk lejohet të rekomandojë ndonjë lloj dëmshpërblimi monetar për të kompensuar dëmin shkaktuar ankuesit.
10. Në rekomandimin e tij të dytë (shih par. 1(b) më sipër), Paneli kishte rekomanduar që ShM-ja duhet t'i udhëzoj të gjitha organet e Misionit, të cilët janë në kontakt me viktimat e supozuara të shkeljes së të drejtave (ose të të afërmve të tyre) që të sigurojnë se në të gjitha komunikimet me ta të komunikojnë me masën e nevojshme të shpejtësisë, zellit dhe kujdesit të domosdoshëm për ta ditur vuajtjen emocionale të bashkëbiseduesit të tyre. Nëse është e nevojshme, gjithashtu ishte rekomanduar që ShM-ja duhet të konsideroj zbatimin e udhëzimeve që përcaktohen më hollësishëm se çfarë mund të nënkuqtoj ky udhëzim i përgjithshëm në rrethana konkrete.
11. Në përgjigje, ShM-ja në letrën e saj të datës 8 dhjetor 2016 ka thënë si në vijim:
- “... EULEX-i i ka ofruar vëmendjen e duhur vendimit të Panelit dhe arsyetimit në të. E kam miratuar themelimin e një Rrjeti Kontaktues për të Drejtat e Njeriut për të siguruar zbatueshmërinë e të drejtave të njeriut nga ana e divizioneve. Një shqyrtim i brendshëm i procedurave dhe udhëzimeve që jetë tani në fuqi do të jenë pjesë e këtij procesi. Unë do të informoj Panelin lidhur me rezultatet e shqyrtimit të brendshëm. Megjithatë nxjerra e udhëzimeve lidhur me ZPS-në është jashtë kompetencave të mijë. Vini re se pritet që Dhoma e Veçantë (“DhV”) dhe ZPS-ja do të nxjerrë Rregulloren e tyre të brendshme të Punës pasi të themelohet Gjykata plotësisht”.
12. Paneli me kënaqësi vëren nismën e ShM-së që të themeloj një Rrjet Kontaktues për të Drejtat e Njeriut për të siguruar zbatueshmërinë e të drejtave të njeriut nga ana e divizioneve. Një masë e tillë është e mundshme që të ndihmoj garantimin e një qasjeje të përbashkët në gjithë Misionin të standardeve themelore të të drejtave të njeriut dhe që të siguroj bashkërendimin e duhur midis Divizioneve në lidhje me këtë çështje.
13. Lidhur me pjesën tjeter të rekomandimeve të Panelit (shih par. 1(c)-(f)), ShM-ja ka thënë si në vijim:

“... ju referohem përgjigjes të datës 29 prill 2016 të dhënë nga paraardhësi im dhe nuk shoh ndonjë arsyë për tu larguar nga pikëpamja e shprehur aty. Kjo është mbështetur nga Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit 2014/685/CFSP të datës 19 shtator 2014 dhe Vendimin e Këshillit 2016/947/CFSP të datës 14 qershor 2016, të cilat përcaktojnë se EULEX-i do të mbështesë procedurat e zhvendosura gjyqësore tek shtetet anëtare. Megjithatë shtetet anëtare kanë

miratuar themelimin e një DhV dhe ZPS që është plotësisht i pavarur nga EULEX-i. Ligji nr. 05/L-053 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 3 gusht 2015, përcakton se ZPS do të marrë përsipër mandatin dhe personelin e SITF dhe “do të jetë zyre e pavarur për hetimin dhe ndjekjen e krimeve brenda juridiksonit të Dhomës së Veçantë”. Përveç kësaj shtetet anëtare kanë vendosur që DhV dhe ZPS do t’i përgjigjen një Ombudspersoni të veçantë dhe në mënyrë specifike përjashtohen edhe DhV dhe ZPS nga juridikzioni i Panelit. Prandaj nuk mund të ushtrohet presion mbi ZPS dhe DhV nga EULEX-i siç sugjerohet në rekomandim. Për këtë arsyе nuk jam në gjendje t’i zbatojë rekomandimet e Panelit”.

14. Paneli vëren mendimin e ShM-së se ajo nuk është kompetente dhe nuk ka autoritet për të ngritur dhe trajtuar rekomandimet e Panelit me TFHS, DhV, ZPS apo shtetet që e mbështesin institucionin e ri.
15. Bazuar në konsideratat e mësipërme, Paneli është i bindur që deri më tanë ShM-ja ka trajtuar në mënyrë të përshtatshme dhe efektive rekomandimet e Panelit dhe ka ofruar përgjigje të duhur në shumicën e këtyre rekomandimeve.

### **PRANDAJ PANELI NJËZËRI**

*Deklaron se ShM-ja ka zbatuar rekomandimet e tij në këtë lëndë vetëm pjesërisht,*

*Mirëpret shenjën që është dhënë nga ShM-ja se ajo do të njoftoj Panelin lidhur me rezultatin e shqyrtimit të brendshëm dhe pret që të merr së shpejti të merr këtë informacion,*

*Vendos të myllur shqyrtimin e kësaj lënde.*

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese